

SHENIMET SHPJEGUESE

Sqarim:

Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 2 i permiresuar Plotesimi i te dhenave të kësaj pjese duhet të bëhet sipas kërkesave dhe strukturës standarte te percaktuara ne SKK 2 te permiresuar. Rradha e dhenies se spjegimeve duhet te jete :

- a) Informacion i përgjithshëm dhe politikat kontabël
- b) Shënime të shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare
- c) Shënime të tjera shpjeguese

A I Informacion i përgjithshëm

- 1 Kuadri ligjor: Ligji 9228 dt 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"
- 2 Kuadri kontabel i aplikuar : Sndartet Kombetare te Kontabilitetit ne Shqiperi.(SKK 2)
- 3 Baza e pergatitjes se PF : Te drejtat dhe detyrimet e konstatuara.(SSK 1)
- 4 Parimet dhe karakteristikat cilesore te perdorura per hartimin e P.F. : (SKK 1)
 - a) NJESIA EKONOMIKE RAPORTUSE ka mbajtur ne llogarite e saj aktivet,pasivet dhe transakcionet ekonomike te veta.
 - b) VIJIMESIA e veprimtarise ekonomike te njesise sone raportuese eshte e siguruar duke mos pasur ne plan ose nevojte nderprerjen e aktivitetit te saj.
 - c) KOMPENSIM midis nje aktivi dhe nje pasivi nuk ka , ndersa midis te ardhurave dhe shpenzimeve ka vetem ne rastet qe lejohen nga SKK.
 - d) KUPTUSHMERIA e Pasqyrave Financiare eshte realizuar ne masen e plote per te qene te qarta dhe te kuptueshme per perdorues te jashtem qe kane njohuri te pergjithshme te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.
 - e) MATERIALITETI eshte vleresuar nga ana jone dhe ne baze te tij Pasqyrat Financiare jane hartuar vetem per zera materiale.
 - f) BESUSHMERIA per hartimin e Pasqyrave Financiare eshte e siguruar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e meposhteme :
 - Parimin e paraqitjes me besnikeri
 - Parimin e perparetise se permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore
 - Parimin e paaneshmerise pa asnje influencim te qellimshem
 - Parimin e maturise pa optimizem te teperuar,pa nen e mbivleresim te qellimshem
 - Parimin e plotesise duke paraqitur nje pamje te vertete e te drejte te PF.
 - Parimin e qendrushmerise per te mos ndryshuar politikat e metodat kontabel
 - Parimin e krahasushmerise duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

A II Politikat kontabël

Per percaktimin e koston se inventareve eshte zgjedhur metoda "FIFO" (hyrje e pare , dalje e pare.(SKK 4)

Vleresimi fillestar i nje elementi te AAM qe ploteson kriteret per njohje si aktiv ne bilanc eshte vleresuar me kosto. (SKK 5; 11)

Per prodhimin ose krijimin e AAM kur kjo financohet nga nje hua,kostot e huamarrjes (dhe interesat) eshte metoda e kapitalizimit ne koston e aktivit per periudhen e investimit.(SKK 5)

Per vleresimi i mepaseshem i AAM eshte zgjedhur modeli i koston duke i paraqitur ne bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar. (SKK 5)

Per llogaritjen e amortizimit te AAM (SKK 5) njesia jone ekonomike ka percaktuar si metode te amortizimit te ndertesave metoden lineare dhe per AAM te tjera metoden e amortizimit mbi bazen e vlefes se mbetur ndersa normat e amortizimit jane perdorur te njellojta me ato te sistemit fiskal ne fuqi dhe konkretisht :

- Per ndertesat me 5 % te vlefes se mbetur
- Komputera e sisteme informacioni me 25 % te vlefes se mbetur
- Te gjitha AAM te tjera me 20 % te vlefes se mbetur

Per llogaritjen e amortizimit te AAJM (SKK 5) njesia ekonomike raportuese ka percaktuar si metode te amortizimit metoden lineare me normen e amortizimit me 15 % ne vit.



Handwritten signature

SHENIME SHPJEGUESE; Per periudhen 01 Janar deri me 31 Dhjetor 2018.

Ne kete aneks paraqiten informacionet shpjeguese ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare te njesise ekonomike DELTA PHARMA-AL shpk.

Njesia ekonomike DELTA PHARMA-AL shpk e krijuar me date 27.04.2006, ushtron aktivitetin e saj ne fushen Tregti Mallrash Farmaceutike, ne qytetin e Tiranës, Autostrada Tirane-Durres, Km.3, Z.kadastrale 2679, Nr.pasurie 19/27/1.

Per periudhen 01 Janar 2018 deri me 31 Dhjetor 2018 jane pergatitur dhe paraqitur paketa e plote e pasqyrave financiare, te cilat japin pamjen te vertete dhe te drejte te pozicionit financiar, performances financiare dhe fluksit te parase gjate kesaj periudhe.

Pergatitja dhe paraqitja e tyre, e cila eshte pergjegjesi e Drejtimit te subjektit, eshte realizuar mbeshtetur ne Ligjin nr 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te permiresuara te miratuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit(KKK). Gjuha e perdorur eshte gjuha shqipe. Monedha e perdorur eshte monedha Leke. Rrumbullakime te vlerave nuk ka. Ngjarjet dhe trasaksionet jane evidentuar gjate gjithë periudhes ushtrimore ne perputhje me SKK nr 1 Kuadri i pergjithshem per pergatitjen e pasqyrave financiare dhe SKK nr 2 Paraqitja e pasqyrave financiare si dhe cdo standard tjetër kombetar ne perputhje me natyren e ngjarjeve apo trasaksioneve te cilat ne menyre te hollesishme do te jepen ne vijim te informacioneve shpjeguese.

❖ Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren BILANC.

Paraqitja e kesaj pasqyre eshte mbeshtur ne paketen e plote te standardevë te permiresuara te miratuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit. Ne vijim do te jepen informacionet shpjeguese per zerat perberes te saj.

I. Informacione Shpjeguese per AKTIVET.

Totali i aktiveve te paraqitura ne pasqyren e Bilancit jane ne vleren **2,713,146,752 leke** detajimi nepermjet informacioneve shpjeguese i te ciles paraqitet si vijon;

✚ Informacione shpjeguese te AKTIVE AFATSHKURTRA

Aktiveve afatshkurtra jane paraqitur ne vleren **1,668,918,586 leke** te cilat jane te perbera nga;

1.Aktive monetare 42,401,318 leke. Ky ze eshte paraqitur ne pasqyre duke u mbeshtetur edhe ne SKK nr 12 *Efektet e ndryshimeve te kurseve te kembimit* dhe paraqet tepricen e llogarise Arka dhe tepricen e llogarise banke, ne monedhen leke dhe euro ne date 31.12.2018. Kursi i kembimit eshte perdorur ne menyre sistematike gjate gjithë ushtrimit te aktivitetit te subjektit per ngjarjet e trasaksionet te cilat jane kryer ne monedha te huaja.

2.Te drejta te arketueshme te cilat jane paraqitur ne vleren **709,331,333 leke** dhe eshte e perbere nga;

Zeri, Nga aktiviteti i shfrytëzimit ne vleren **616,885,982 leke**, i cili eshte evidentuar edhe ne perputhje me SKK nr 3 ne te cilen përfshihen të gjitha të drejtat e krijuara gjate periudhes



legj

ushtrimore ndaj klientave për shitjen e mallrave, produkteve dhe shërbimeve me arkëtim të mëvonshëm, te paraqitura me vleren neto te realizueshme.

Zeri, Të tjera ne vleren **59,736,068 leke** perfshin parapagimet e furnitoreve per blerje qe do te realizohen ne periudhen e ardhshme ushtrimore, si dhe huadhenie afatshkurtra te njesise ekonomike.

Zeri, Kerkesa ndaj tatim taksave ne vleren **32,709,282 leke**, pëfshihen të gjitha të drejtat e njësisë ndaj të tretëve, te krijuar gjate periudhes ushtrimore, dhe detajimi i saj paraqitet si vijon;

Emertimi	Ref.	Vlera
Shteti - TVSH per tu marre	4454	32,709,282
Totali		32,709,282 leke

3. Inventari i paraqitur ne vleren **883,199,182 leke**, i cili eshte i perbere nga;

Zeri Mallra ne vleren **883,199,182 leke** jane njohur dhe vleresuar ne perputhje me SKK nr 4 *Inventaret*. Kostoja e inventarit eshte vleresuar me metoden e kosos mesatare te ponderuar. Detajimi i saj eshte sipas pasqyres se inventarit ne fund te shenimeve shpjeguese. (Lista e plote e inventarit ne fund).

Zeri Shpenzime të shtyra ne vleren **33,986,753 leke** perfaqsojne parapagimet per punime te njesise ekonomike.

✚ Informacione shpjeguese te **AKTIVET AFATGJATA**

Aktivët afatgjatë janë paraqitur ne Vleren Kontabel Neto **1,044,228,167 Leke**. Ato janë evidentuar edhe ne perputhje me SKK nr 5 Aktivët afatgjatë materiale dhe aktivët afatgjatë jomateriale. Paraqitja e tyre eshte bere nepermjet politikës kontabel Metoda e Kosos. Perberja e ketij zeri paraqitet si vijon;

1. Aktive afatgjatë materiale janë ne vleren **1,044,228,167 Leke** dhe eshte i perbere nga Zeri *Toka dhe ndërtesa* ne vleren **966,714,077 leke** si dhe zeri *Të tjera Instalime dhe pajisje* ne vleren **77,514,089 Leke**. Metoda e perzgjedhur per amortizimin eshte mbi vleren e mbetur kontabel dhe amortizimi per vitin 2018 eshte llogaritur ne vleren **48,279,610 leke**.

Ne te jane te perfshire elementet e meposhtem;

Nr. Llogarie	Emertimi i Llogarise	Monedha	Debi	Kredi
21101	Prona Mezez, Tirane (TOKE)	LEK	155,016,286	
21201	Ndertesat (Him Kolli)	LEK	267,274,080	
21202	Ndertesat (magazina Mezes)	LEK	604,839,123	
213	Instalime teknike, makineri, pajisje, instrumente dhe vegla pune	LEK	3,503,868	
215	Mjete transporti	LEK	89,349,410	
218101	Mobilje dhe Orendi	LEK	13,755,696	
218102	Pajisje Zyre	LEK	133,264	



218201	Pajisje Informative	LEK	31,016,914	
2188	Të tjera	LEK	5,749,543	
218801	Rregullime te pergjithshme	LEK	5,281,207	
2812	Për ndërtesat	LEK		60,415,412
2813	Për instalime teknike, makineri, pajisje, instrumenta e vegla	LEK		303,382
2815	Për mjetet e transportit	LEK		41,314,984
281801	Per mobilje dhe orendi	LEK		9,028,264
281802	Per pajisje informatike	LEK		14,681,627
281803	Per pajisje zyre	LEK		27,959
281804	Per te tjera	LEK		2,933,683
281805	Per rregullime te pergjithshme	LEK		2,985,915
		Totali:	1,175,919,391	131,691,224
		Diferenca:	1,044,228,167	

II. Informacione Shpjeguese per DETYRIMET.

Detyrimet e paraqitura ne pasqyren e Bilancit jane ne vleren **1,187,506,105 leke** dhe perbehet nga detyrime te periudhave afashkurtra dhe afatgjata. Detajimi jepet nepermjet informacioneve shpjeguese si vijon;

✦ Informacione shpjeguese te DETYRIMEVE AFATSHKURTRA

Detyrimet afatshkurtra jane paraqitur ne total ne vleren **666,284,203 leke** dhe jane te perbera nga detyrimet ndaj furnitoreve, hua te tjera dhe detyrime ndaj shtetit per tatime dhe taksa.

- Titujt e huamarrjes ne vleren **0 leke** perbejne detyrimin e njesise ekonomike ndaj kontributit te ortakut te vetem te saj.

- Arkëtime në avancë për porosi ne vleren **2,535,016 leke** perbejne arketimet ne avance te klienteve per shitje qe do te kryhen gjate periudhes se ardhshme ushtrimore.

- Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit ne vleren **631,485,251 leke** perbejne detyrimin ndaj furnitoreve per blerje mallrash dhe sherbimesh te papaguara ende per vitin 2018.

- Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore ne vleren **13,183,718 leke** perbejne detyrimin per pagat e personelit dhe sigurimet shoqerore dhe shendetsore per muajin Dhjetor 2018 dhe detajohet si vijon;

Elementi	Ref	Vlera
Pagat e personelit	421	10,929,933
Sig shoq&shend	431	2,253,785

- Të pagueshme për detyrimet tatimore ne vlere **19,080,218 leke** perbejne detyrimin per muajin Dhjetor 2018 dhe detajohet si vijon;

Elementi	Ref	Vlera
Tatim fitimi	444	17,027,205
TAP	447	2,024,333



[Handwritten signature]

Tatim burim

447

28,680

✚ Informacione shpjeguese te DETYRIMEVE AFATGJATA

Detyrimet afatgjata jane paraqitur ne total ne vleren **521,221,902 leke** te cilat perfaqsojne overdraftet dhe kredite bankare te marra nga njesia ekonomike gjate vitit 2018.

✚ Informacione Shpjeguese per KAPITALIN

Kapitali i paraqitur ne vleren **1,525,640,647 leke** dhe eshte i perbere nga zerat Kapital i nenshkuar, Rezerva rivleresimi, Rezerva te tjera, Fitime te pashperndara dhe Fitim / Humbje e vitit detajimi i te cilave do te jepet ne informacionet shpjeguese.

1. Informacione shpjeguese te zerit KAPITAL

Ne kete ze jane paraqitur kapitali i kontribuar nga aksionerët ose nga ortakët dhe jane përmbledhur tepriat kreditore të llogarive vijuese:

Emertimi	Ref	Vlera
Kapitali i paguar,	101	1,093,200,000
Totali		1,093,200,000 leke

Ne perputhje me aktin e themelimit date 27 Prill 2006 dhe vendimit te ortakeve per zmadhim kapitali, kapitali i nenshkuar eshte i perbere nga kuota ose aksione, gjithsej 1 pjese me vlere nominale 1,093,200,000 leke pjese.

2. Informacione shpjeguese te zerit REZERVA RIVLERESIMI

Zeri *Rezerva Rivleresimi* paraqitet ne vleren **229,836,274 leke** perfshin vleresimin me cmim tregu te prones TOKE ne Mezez dhe te nderteses Him Kollit.

3. Informacione shpjeguese te zerit REZERVA TE TJERA

Zeri i mesiperm perbehet nga rezervat e krijuara gjate viteve te meparshme ushtrimore dhe eshte ne vleren **62,723 leke**.

4. Informacione shpjeguese te zerit FITIME TE PASHPERNDARA

Zeri *Fitime te pashperndara* paraqitet ne vleren **0 leke** dhe perfshin fitimet që njësia ekonomike ka akumuluar nga periudhat paraardhëse.

5. Informacione shpjeguese te zerit FITIME TE VITIT

Zeri *Fitime te vitit* paraqitet ne vleren **202,541,650 leke** dhe paraqitet rezultati i periudhës rrjedhese ushtrimore të njësisë raportuese ashtu si rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve pasi eshte zbritur tatimi mbi fitimin.



❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE.**

Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve eshte paraqitur bazuar ne klasifikimin e shpenzimeve sipas natyres. Ne kete periudhe ushtrimore ka rezultuar nje fitim ne vleren **202,541,650 leke**.

Zeri Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit te paraqitura ne pasqyre evidenton te gjitha shitjet e realizuara me vleren e tyre neto **3,390,692,582 leke**. Gjate periudhes ushtrimore jane realizuar shpenzimet e meposhtme;

Zeri Të ardhura të tjera të shfrytëzimit evidenton vleren e te ardhurave nga shitja e aktiveve afatgjate materiale ne vleren **5,553,295 leke**.

Zeri Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme te paraqitura ne vleren **2,723,805,228 leke** perfaqesojne koston e mallrave te blera per qellime rishitje.

Zeri Shpenzime të personelit i cili eshte i paraqitur ne vleren **163,896,438 leke** perfaqeson:

1. Shuma *Paga dhe shpërblime* gjate periudhes ushtrimore 01.01-31.12.2018 ne vleren **150,334,808 leke**
2. Shuma *Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)* gjate periudhes ushtrimore 01.01-31.12.2018 ne vleren **13,561,630 leke**.

Nga keto vlera vetem shuma **10,929,933 leke** eshte ende e papaguar e cila eshte pasqyruar ne bilanc, dhe per te cilen jane dhene informacione shpjeguese me larte.

Zeri Shpenzime të tjera shfrytëzimi te cilat jane te paraqitura ne vleren **227,954,679 leke** perfaqesojne shpenzimet te cilat jane kryer per zhvillimin e aktivitetit te njesise ekonomike, si Furnitura dhe nentrajtme, Taksa bashkie, si dhe te tjera shpenzime.

Zeri Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësiti ekonomike brenda grupit) te paraqitura ne vleren **13,869,601 leke**, eshte paraqitur ne perputhje edhe me SKK nr nr 12 *Efektet e ndryshimeve te kurseve te kembimit*. Keto perfaqesojne diferencen pozitive te kembimit nga monedhat e huaja ne monedhen vendase leke si dhe te ardhura te tjera financiare.

Zeri Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësiti ekonomike brenda grupit) te cilat jane te paraqitura ne vleren **(7,538,930) leke**, perfaqesojne shpenzimet qe vijne nga interesa e kredive bankare, interesat e overdrifteve etj.

❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren CASH FLOW.**

Ne pasqyren e flukseve monetare jane paraqitur flukset hyrese dhe dalese te mjeteve monetare në njësine ekonomike gjatë periudhës korrente kontabël. Paraqitja eshte bere sipas metodës indirekte.

Gjate periudhes kontabel ka rezultuar;

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit ne vleren **17,941,464 leke**. Fluksi pozitiv ka ardhur pasi flukset dalese te mjeteve monetare per kryerjen e shpenzimeve si psh, paga,



detyrime per kontribute te sigurimeve dhe te tatim-taksave jane me te ulta se flukset hyrese te mjeteve monetare gjate ushtrimit normal te aktivitetit nga njesia ekonomike.

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit ne vleren **(161,957,356) leke** i cili ka rezultuar nga blerja dhe shitja e aktiveve afatgjate materiale.

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit ne vleren **143,458,427 leke** i cili ka rezultuar nga marrja dhe shlyerja e kredise dhe ovd bankare.

❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren NDRYSHIMEVE TE KAPITALIT .**

Ndryshimet ne zerin Kapital kane ardhur si rezultat;

1. Zmadhimi i kapitalit te nenshkruar ne vleren 205,464,800 leke.
2. Rritjes se rezerva te tjera ne vleren 50,481 leke.
3. Zvogelimit te fitimit te pashperndare ne vleren (205,515,281) leke.
4. Fitim / Humbje e vitit ne vleren 202,541,650 leke.

Informacionet shpjeguese per zerat e mesiperm jane dhene ne pasqyren e Bilancit.

Drejtuesi

Eduard Curraj



Eduard Curraj